




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, gje.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 38.1 shkronja (s), nenin 39.1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të 13.04.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 27.04.2011, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E 50 (PESËDHJETË) BURSAVE DHE 20 (NJËZET)
SHPËRBLIMEVE PËR STUDENTË TË DALLUAR

I

Me këtë vendim lejohet ndarja e **50 (pesëdhjetë) bursave** për student të dalluar të Komunës së Gjilanit për vitin akademik 2010/2011, (për afatin kohor 01.09.2010 deri më 30.06.2011 dhe të cilët kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve), dhe atë si në vijim:

1. Tridhjetë (30) bursa në lartësi prej 60€ për student të Komunës së Gjilanit të cilët studiojnë në Universitetet e Kosovës jashtë Komunës së Gjilanit.
2. Njëzet (20) bursa në lartësi prej 40€ për student të Komunës së Gjilanit të cilët studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.

II

Po ashtu me këtë vendim lejohet ndarja e **20 shpërblimeve** për student të dalluar të Komunës së Gjilanit në lartësi prej 200€.

III

Përzgjedhjen e studentëve përfitues të bursave dhe shpërblimeve do të bëhet në bazë të konkursit të shpallur nga Drejtoria për Arsim dhe kriteret e aprovuara nga Kuvendi i Komunës për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria për Arsim, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset kryesuesi i KK-Gjilani

V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit,

01.Nr. 16/5692
Gjilan, më 27.4.2011

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues